



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2021:282600

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05555105

**E.nr.805/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorëve : Sh.Q., L.Q., F.Q. dhe Z.Q., të cilët i përfaqëson av Qëndrim Reçica nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shujtës, më datë 08.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përbarimore në lëndën **E.nr.805/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.805/23, të datës 22.05.2023, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shujtës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2021:282600, të datës 04.10.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 03.10.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,379.50 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.805/23, më datë 08.04.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**